



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**  
Mbledhja nr.54/2018  
Prishtinë, më 28.12.2018, në orën 10:30  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Liburn Aliu, Lutfi Zharku, Hykmete Bajrami, Muharrem Nitaj, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtare.

**Munguan:** Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Glauk Konjufca dhe Memli Krasniqi, anëtarë.

**Pjesëmarrës të ftuar:** Arsim Janova, U.D., kryesues i Zyrës së Rregullatorit për Energji; Endrit Shala, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, dhe Valon Prestreshi, kryetar i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

**Pjesëmarrës tjerë:** Besim Sejfiqaj, Rifat Blakaj, Ymer Fejzullahu dhe Gani Buçaj–ZRRE; Durim Limaj dhe Berat Ahmeti –MTI; Donika Bekteshi – KDI, dhe Liridon Gashi – SEEF.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

**Mbledhjen e kryesoi:** Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Raportim i institucioneve ligjzbatuese lidhur me ndërprerjet e energjisë elektrike;**
3. **Raportim i institucioneve ligjzbatuese lidhur me çmimin e naftës;**
4. **Të ndryshme.**

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

## 2. Raportim i institucioneve ligjzbatuese lidhur me ndërprerjet e energjisë elektrike

**Kryetarja**, lidhur më këtë pikë të rendit të ditës, tha se propozues është znj. Hykmete Bajrami, të cilës ia dha fjalën për ta paraqitur çështjen e ngritur.

**Hykmete Bajrami** tha se kam kërkuar të ftohen përfaqësuesit e ZRRE-së, që të njoftohemi me masat e marra për reduktimet e ashpra me energji elektrike, që po ndodhin në këto dy muajt e fundit në këtë kohë të stinës së dimrit nga ana e KEDS-it. Ajo theksoi se duke i parë shqetësimet e shumë qytetarëve për ndërprerje të shumta të energjisë elektrike që janë të pajustificueshme, ne presim nga ju, si përfaqësues të ZRRE-së, po ashtu edhe nga Ministra e Zhvillimit Ekonomik, më qenë më efikas në monitorimin e furnizimit më energji elektrik, derisa qytetarët po i paguajnë më kohë faktuarat e energjisë shpenzuar, dhe meqenëse se KEDS-it më kontratë e ka për obligim që t'i furnizoi 24 orë me energji elektrike konsumatorët, atëherë, duhet të kërkohet përgjegjësi prej KEDS-it, së ku janë problemet e reduktimeve të shumta që po ndodhin kohëve të fundit. Znj. Bajrami, potencoi së ne fund të takimit duhet si komision të dalim më disa konkluzione, sepse ndërprerjet e energjisë janë ta pajustificueshme.

**Muharrem Nitaj** tha se ajo që kërkojmë tani prej përfaqësuesve të ZRRE-së, se cila është e vërteta për ndërprerjet e energjisë elektrike? Është thënë se ka pasur import të energjisë në kohën kur ka ndërprerje të vazhdueshme të energjisë në Kosovë, cila është e vërteta këtu? Dhe, nëse ka shkelje të tilla, cilat janë masat që i keni ndërmarrë ju si ZRRE? Pasi që situata është emergjente edhe ne duhet të veprojmë me emergjencë, është mirë të kemi një qëndrim të përbashkët si komision.

**Duda Balje** tha që problemi i ndërprerjes së energjisë na paraqitet gjatë gjithë kohës së dimrit, sidomos në komunën e Dragashit, tani e kam njoftimin që deri në 20 orë ka ndërprerje te energjisë në atë zonë. Po ashtu, dhe në disa fshatra të komunës së Prizrenit, ju thuhet banoreve se janë duke bërë pastrimin e linjave dhe ato fshatra nuk kanë rrymë nga 6 orë dhe çka mund të bëni ju si ZRRE? Pyeti lidhur më Hidrocentralin e Dragashit që nuk po mundet që 3 vjet më pas kyçje në sistemin energjetik, cili është vlerësimi që ka dhënë në këtë rast ZRRE-ja?

**Arsim Janova, U.D., kryesues i Zyrës së Rregullatorit për Energji**, iu përgjigj pyetjeve duke bërë sqarime, se pari paraqiti si shqetësim mos kompletimin e Bordit të ZRRE-së, ku tha po kemi vështirësi në vendimmarrje pasi që Bordi ende nuk është i kompletuar. Ai tha se ne, si ZRRE, jemi duke bërë monitorim të vazhdueshëm ndaj KEDS-it, që e ka shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike në Kosovë, lidhur me ndërprerjet e energjisë, por kemi kapacitete të kufizuara për shkak të numrit të punëtorëve që për monitorim është i vogël dhe për këtë kemi kërkuar që të na lejohet punësimi i së paku 3 punëtorëve, në mënyrë që të kemi monitorim sa më efikas. Nga KEDS-i na është thënë se arsyeja e ndërprerjes së energjisë në disa raste është se e kanë pasur mirëmbajtjen e planifikuar të disa linjave më herët dhe për këtë arsye ka pasur ndërprerje të energjisë elektrike në disa vende. Ai theksoi se komisioni i krijuar nga

ZRRE-ja për monitorim të punimeve në KEDS, ka vërtetuar që 4-5 linja janë vazhdimisht duke u mirëmbajtur, prandaj ne, si ZRRE, iu kemi kërkuar që gjatë kohës së sezonës së dimrit mos të fillohet me investime në ato vend ku nuk mund të përfundojnë në kohë punimet e planifikuara. Po ashtu kemi konstatuar se për shkak të motit të keq kemi pasur shumë prishje në terren sidomos në komunën e Fushë- Kosovës. Po ashtu, për komunën e Dragashit iu kemi rekomanduar që të forcohet linja për shkak terrenit malor që ekziston në atë zonë. Lidhur me Hidrocentralin e Dragashit e kemi kushtëzuar që një vit KEDS-in që ta ndërtojë linjën e re për kyçje në sistemin energjetike e kanë filluar punën, por është trase 15 km e gjatë dhe është proces që zgjatë edhe për disa muaj deri në përfundim. Ai potencoi, se po ashtu edhe KEK-u, si prodhues më furnizim më energjinë elektrike, i ka pasur disa prishje gjatë këtyre muajve dhe ndërmarrja KOSTT, po i ka problemet e veta në linjat e kyçjes, prandaj edhe këto janë problemet e ndërprerjes së energjisë elektrike. Ndërsa, lidhur me eksportin e energjisë, tha që ka pasur kontrata që janë bërë më herët dhe kjo ka ndodhur në këtë rast dhe për këtë çështje duhet të përgjigjet KOSTT-i. Po ashtu, KEDS-i është i obliguar kur ka prishje në raste emergjente me gjetur tregun për import të energjisë në mënyrë që mos të ketë reduktime për konsumatorët.

**Dardan Sejdiu** kërkoj sqarime lidhur me diferencat e importit dhe eksportit, në këtë rast a kemi të bëjmë me bilanc pozitiv apo negativ dhe në muajin nëntor dhe dhjetor, a kemi neto import apo eksport.

**Rifat Blakaj, ZRRE**, tha që kur është hapur Njësia e monitorimit sipas të dhënave kemi neto import dhe në bazë të dhënave të detajuara është eksportuar shumë pak, vetëm gjatë natës kur ka qenë muaji nëntor, më datë 21,22 dhe 23. Ndërsa, kur ka rënë “Blloku A” kemi pasur probleme dhe në këtë kohë ka pasur reduktime dhe në këtë rast i kemi rekomanduar KEDS-it që të ndërpriten të gjitha mirëmbajtjet për muajin nëntor, ndërsa në fillim të dhjetorit kemi pasur rritje të importit për mos me pasur ndërprerje të energjisë. Ai theksoi që në 90% të ndërprerjeve janë realizuar punimet dhe iu kemi thënë që verës duhet të punohet, e jo dimrit.

**Kryetarja** theksoi se gjendja me reduktimet energjetike në këtë periudhë është shqetësim për qytetaret dhe për të gjithë neve, dhe kjo çështje varet nga shumë institucione dhe palët që kanë përgjegjësi edhe për këtë i kemi ftuar në komision përfaqësuesit e ZRRE-së, se kush nuk po e zbaton kontratën dhe me cilët investitor është problemi. Prandaj ne jemi këtu me i parë problemet se kush nga këto palë po ngecin.

**Hykmete Bajrami** tha se morëm shumë sqarime, por problemi qëndron te përgjegjësia e KEDS-it, për furnizim 24 orë. Ata paskan filluar me justifikuar ndërprerjen e energjisë që nuk po gjejnë treg. Në këtë rast a keni mekanizma ju, ZRRE-ja, me vërtetuar se a po gjejnë treg apo jo dhe a keni kompetenca më ndërmarrë masa ligjore në këtë rast ndaj KEDS-it?

**Ymer Fejzullahu, ZRRE**, tha që kontratën me KEDS-in, e mbikëqyre Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Ne, si ZRRE, jemi vetëm rregullator, ndërsa përgjegjësia e linjave është e KOSTT-it. Ai theksoi se në rastet e ndërprerjes kanë obligim KEDS-i dhe KOSTT-i të gjejnë alternativë të blerjes së energjisë. Arsyetimi i tyre është se në disa raste ka pasur mungesë të blerjes së energjisë në tregun rajonal.

**Lutfi Zharku** pyeti se nëse në investimet që po i bën KEDS-i po hynë tarifat, atëherë sa janë investimet e lejuara me kontratë, dhe këto investime a janë pjesë e kontratës dhe pse po tariforen pasi këtu po gjendet arsyetimi dhe mundet të rritet çmimi i energjisë elektrike për konsumatorë?

**Ymer Fejzullahu, ZRRE**, tha që në këto investime që po bëhen nga KEDS-i në mënyrë që të zvogëlohen tarifat energjisë për konsumatorët, atëherë duhet të gjinden burimet e financimit nga kredit bankare.

**Hykmete Bajrami** propozoi që ZRRE-ja të dalë me sqarime për opinionin publik duke dhënë sqarime se e kujt është përgjegjësia për ndërprerje të energjisë dhe cilët janë shakataret se a ka dështuar KOSTT-i apo KEDS-i? Dhe duhet të ju rekomandohet që gjatë fazës së dimrit të mos ketë investime në terren, në mënyrë që mos të ketë reduktime të energjisë për konsumatorët. Ajo tha se tani mund të kemi qëndrim të përbashkët si komisionin, pas i dëgjuam përfaqësuesit e ZRRE-së si palë përgjegjëse, se ku janë problemet.

**Muharrem Nitaj**, kërkoi nga përfaqësuesit e ZRRRE-së që të jenë më konkret dhe shpjegohet më qartë për opinionin publik gjendje momentale e ndërprerjes me reduktimi të energjisë elektrike.

**Arsim Janova, U.D., kryesues i Zyrës së Rregullatorit për Energji**, sqaroi se nuk kanë problem më menaxhmentin e KOSTT-it, por problemet kanë dalë më infrastrukturën e sistemit energjetik në terren të linjave të transmetuese që janë të lidhur me vendet e rajonit. Ai tha që nëse KEDS-i nuk i përfill rekomandimet e ZRRE-së, atëherë ekzistojnë masat ligjore që duhet të ndërmerren.

*Pas diskutimeve komisioni njëzëri nxori këtë:*

#### *Përfundim*

- 1. Komisioni i dha mbështetje Zyrës së Rregullatorit për Energji në marrjen e masave ligjore ndaj palëve, në këtë rast ndaj KEDS-it dhe gjitha institucioneve që janë shkaktar në ndërprerje dhe mos furnizime të energjisë elektrike për konsumatorët;*
- 2. Zyra e Rregullatorit për Energji të njoftojë opinionin publik lidhur me gjendjen dhe shkaktaret e ndërprerjes me mos furnizimin 24 orë me energji elektrike ndaj konsumatorëve;*
- 3. Zyra e Rregullatorit për Energji në çdo kohë të raportoj para komisionit për masat e marra në përputhje me ligjin.*

### **3. Raportim i institucioneve ligjzbatuese lidhur me çmimin e naftës**

**Kryetarja** tha se për këtë pikë të rendit të ditës, propozuesi është z. Muharrem Nitaj, të cilit ia dha fjalën, për të paraqitur çështjen e ngritur.

**Muharrem Nitaj** tha që arsyeja pse kam kërkuar këtë pikë, është se në Kosovë nafta dhe benzina po vazhdon të shitet me çmime shumë më të lartë se sa standardi që kemi, dhe përkundër asaj se në shtetet e rajonit dhe në botë derivatet kanë pësuar rënie në çmim. Andaj, kërkoj nga të ftuarit që të tregohet konkretisht ku është problemi i mos uljes së çmimit të produkteve të naftës dhe benzinës për një kohë kaq të gjatë, a ka ndonjë marrëveshje të fshehtë të kompanive që merren më shitjen e këtyre produkteve? Ne, si komision, duhet të shikojmë mundësinë, çka mund të bëjmë në aspektin e marrjes së masave ligjore për t'i detyruar këto kompani që t'i zbresin çmimet e naftës dhe benzinës në bazë të tregut të lirë që zhvillohet dhe në vendet e rajonit dhe botës? Propozoi që komisioni për çështjen e çmimeve të derivateve të naftës është mirë që ta ketë një qëndrim të përbashkët për t'i mbrojtur konsumatorët.

**Valon Prestreshi, kryetar i Autoritetit të Kosovës të Konkurrencës**, tha që kanë bërë një analizë për kompanitë që kanë 20-25% të tregut të produkteve të naftës dhe benzinës, dhe deri më tani në bazë të dhënave, asnjë kompani nuk ka fuqi dominues në shitjen e këtyre produkteve dhe tregu është liberal dhe në aspektin ligjor nuk ka pozitë dominuese për asnjë kompani. Por gjatë inspektimit Autoriteti Kosovës i Konkurrencës, ka gjetur që dy kompani kanë fuqi dominues në treg në shitjen e produkteve të naftës dhe benzinës dhe për këtë e kemi njoftuar Qeverinë dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë që të merren konkretisht me çështjen e rritjes së çmimit. Ai theksoi se kemi Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe departamentin përkatës, ku janë në terren për të na njoftuar me shkeljet e mundshme të rritjes së çmimit të derivateve të naftës, po sa t'i marrim të gjitha të dhënat e nevojshme si Autoritet Kosovës i Konkurrencës, do të dalim më një qëndrim. Potenco i se këto informata duhet të përpunuar me shumë kujdes nga hetuesit tanë, bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës përkatësisht nën 60, mirëpo, nuk ka pasur fakte të mjaftueshme për përfundimin e saj ose konfirmimit të kartelit.

**Hykmete Bajrami** tha që në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, përkatësisht Autoriteti Kosovës i Konkurrencës, duhet të ketë pasur rast të tilla kur ka rënë çmimi në berëzën botërore, por këto kompanitë tona nuk e kanë ulur çmimet e derivateve të naftës. Por është MTI-ja që i ka bazën e të dhënave të qarkullimit të derivateve të naftës dhe duke u bazuar në Ligjin për produktet e naftës, në nenin 11 mund të ndërmerre masat ligjore, po ashtu Qeveria që mundet më pasur ndikim në Doganë më ndal këtë trend të rritjes së derivateve të naftës, pasi që kompanitë tona që merren më shitjen e këtyre produkteve, nuk kanë fakte të bazuar, që duhet jetë ky çmim kaq i lartë. Ajo potenco i se kjo çështje për rritjen e lartë të çmimit të derivateve të naftës, as nuk mund të justifikohet ma tutje nga MTI-ja, pasi që e ka bazën ligjore, siç e ceka në nenin 11 të ligji për Naftën.

**Dardan Sejdiu** tha që është shqetësuese mbajta e gjatë e këtij çmimi të derivateve të naftës, kur berëza e çmimit botëror ka ulje për këto produktet të naftës dhe benzinës. Ai theksoi se krahasuar dhe me shtetet e rajonit çmimi i naftës dhe benzinës është 16 cent më i shtrenjtë se sa në shtetin më të afërt fqinj Maqedoninë, për këtë gjë nuk ka nevoja analizë, pasi që tregu ndërkombëtarë këtyre produkteve nuk ka ndryshuar, por duhet vetëm të kërkohej përgjigjeje tek institucionet përgjegjëse. Është e çuditshme që Maqedonia që është vetëm 2 orë nga Prishtina të jetë dallim i çmimit për një litër naftë ose benzinë për 16 cent më i lirë, andaj MTI-ja duhet të veproj se kjo është konsum ditor për nevojat e qytetarëve dhe duhet të mbrohen në këtë rast konsumatori dhe konkurrenca.

**Muharrem Nitaj** potencoi së duhet të përcaktohet niveli i çmimit minimal dhe maksimal i derivateve të naftës dhe për këtë çështje presin dhe qytetaret që duhet të ketë ulje të çmimit, më pak të barazohen më çmimet e shteteve të rajonit. Pasi që akoma në vendin tonë çmimi i naftës dhe benzinës, po vazhdon të jetë i lartë, edhe pse kudo në shtetet e rajonit ka rënie.

**Endrit Shala, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë**, i njoftoi anëtarët e komisionit se fillimisht ka pasur takim më përfaqësuesit e Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës dhe në takim kemi kërkuar më mirësi nga shoqata e naftëtarëve që çmimi i lartë i naftës dhe benzinës, të rregullohet më çmimin e berëzës botërore. MTI-ja deri më tani nuk ka vërejtur që ka marrëveshje në mes kompanive që merren shitjen e derivateve të naftës. Z. Shala, tha që arsyetimi i kompanive, pse çmimi është rritur është se kanë numër të madhe të punëtoreve dhe mirëmbajta e pikave shitëse po ju kushton në koston e përgjithshme të shpenzimeve dhe për këtë gjë kemi informata nga Dogana se fitimi nuk është i madh sepse tatimi është i madh. Ndërsa sa i përket Ligjit të Naftës që mund të përdoret nenin 11 i këtij ligji, e kemi analizuar në MTI-i, por ka vështirësi në përdorim të dy paragrafët e nenit 11.2 dhe 11.3 ku asnjë dispozitë nuk përcakton qartë rregullimin e çmimit të naftës dhe benzinës duke pasur parasysh lëvizjet, qoftë edhe ditore që janë shpeshta të tregut të këtyre produkteve është vendim i vështirë që nuk mund të merret lehtë për t' u realizuar në terren.

**Hykmete Bajrami** tha që arsyetimi i kompanive dhe shoqatës së naftëtarëve së kanë shpenzime të mëdha dhe numër të madhe të punëtorëve nuk qëndron, kur dihet që këto shpenzime i kanë pasur dhe më përpara. Ndërsa në nenin 11 të Ligjit për naftën duhet të caktohet marzha e fitimit. Ai theksoi kohën kur e ka drejtuar MTI-in janë mobilizuar si institucione më marrjen e masave ligjore dhe atëherë kompanitë kanë reflektuar në uljen çmimit të derivateve të naftës.

**Endrit Shala, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë**, njoftoi komisionin se ka nxjerrë një vendim që urdhëron operatorët ekonomikë që shesin derivate që në çdo pikë shitëse të vendosin tabelat treguese të çmimit të këtyre produkteve. Kjo urdhëresë obligon të gjithë operatorët ekonomik që afrojnë shërbime të shitjes së produkteve të naftës që çdo pikë shitëse të vendosin tabelat treguese të çmimeve të produkteve të naftës dhe benzinës. Kjo urdhëresë është në vazhden e mbrojtjes së konsumatorit dhe transparencës me çmime, që qytetari i Kosovës duhet të jetë i njoftuar gjithmonë para se të furnizohet me derivate. Ai theksoi se ndër prioritet kryesorë të tij është mbrojtja e konsumatorit dhe ne po punojmë çdo ditë që të mbrojmë konsumatorin tonë, t'i rrimë afër duke i kontrolluar produktet për cilësinë e tyre në treg. Prandaj, na duhet një rregullator që përcakton tavanin e çmimit pasi një vendim të një rregullator, për më venë marzhën e fitimit, atëherë MTI-ja mund të veprojë në marrjen e vendimit për rregullimin e tregut të derivateve të naftës.

**Hykmete Bajrami** potencoi nëse a ka të dhëna nga Dogana se sa është çmimi dhe fitimi në pikën doganore në kufi për derivatet të naftës, atëherë e gjejmë dallimin më vendet e rajonit se sa është diferenca prej pikës doganore deri në pikën e shitjes. Pastaj këtë rekomandim MTI-ja të ia propozon Qeverisë për miratim, kjo është mënyra më e thjeshtë për me pasur ndikim në uljen e çmimit të derivateve të naftës.

**Dardan Sejdiu** tha se çështja është shumë i thjeshtë vetëm a ka vullnet politik le të tregohet për me ndalë këtë çmimi tepër të lartë që ka një diferencë prej tregut të shtetit Maqedonisë prej 16-deri 18 cent për një litër naftë ose benzinë, kjo po ndodh që 21 ditë, është e tepërt. Andaj, nëse një shtet është i vetëdijshëm për këtë që po ndodh në këtë drejtim duhet masa duke e ruajtur mirëqenien e përgjithshme të qytetareve të vet dhe arsytimi i kompanive është jo real, sidomos për numrin e punëtorëve.

**Endrit Shala, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë**, tha pas konsultimeve të shumta që i kemi pasur në MTI-i në aspektin ligjor asnjë zyrtar, nuk na ka rekomanduar të marrim vendim në bazë të ligjit.

**Lutfi Zharku** tha nëse ka vullnet për këtë çështje duhet një analizë e mirë dhe detajuar për të vlerësuar çdo rrethanë, pastaj duhet një rekomandim se si të veprohet në këto rrethana që i krijon tregu.

*Pas diskutimeve komisioni njëzëri nxori vendosi:*

### ***Përfundim***

*Komisioni mbështetë Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, që të marrë masa në përputhje me ligjin për të ndaluar rritjen e çmimit të karburanteve.*

#### **4. Të ndryshme Çështjet vijuese.**

**Mbledhja përfundoi në orën 12:00.**

**E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit**

**Kryetarja e komisionit,**

-----  
**Sala BERISHA SHALA**